

ANGAZHIMI PËR VEPRIM TË PËRBASHKËT - EJA KOSOVË

UDHËZIME PËR APLIKIM PËR GRANTE INSTITUCIONALE

Bashkëfinancuar nga:

RRETH ANGAZHIMIT PËR VEPRIM TË PËRBASHKËT – EJA KOSOVË

Angazhimi për Veprim të Përbashkët (EJA Kosovë) është program i KCSF-së që mbështet nismat e shoqërisë civile përmes granteve dhe ngritjes së kapaciteteve me synimin e përgjithshëm për të dhënë kontribut domethënës në zhvillimin demokratik dhe socio-ekonomik të Kosovës. E themeluar si mekanizëm i financimit ku disa donatorë i bashkojnë fondet e tyre për përkrahjen e shoqërisë civile, EJA Kosovë aktualisht financohet bashkërisht nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Suedia.

Duke vënë në plan të parë angazhimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në punën e shoqërisë civile, EJA Kosovë synon të kontribuojë drejt dy objektivave kryesorë (a) rritjes së angazhimit të qytetarëve në jetën publike përmes avokimit me pjesëmarrje të shoqërisë civile dhe (b) t'u mundësohet OSHC-ve që t'i forcojnë marrëdhëniet e tyre me qytetarët dhe t'i përmirësojnë kapacitetet organizative.

EJA Kosovë bazohet në premisën që përmes sistemeve të përshtatura të gjithëpërfshirjes, transparencës dhe llogaridhënies nga njëra anë, dhe qasjes dhe komunikimit më të mirë me komunitetin, nga ana tjetër, OSHC-të, duke i përfshirë qytetarët në punën e tyre, mund të ndërtojnë bazë më të fortë dhe më të angazhuar të mbështetjes. Kjo forcon qytetarët dhe mundëson që ato t'i përfaqësojnë më mirë nevojat dhe shqetësimet e komunitetit. Së bashku me qeverisje të brendshme, transparencë dhe angazhim më të mirë të qytetarëve, kjo do të kontribuojë në rritjen e besimit publik në OSHC-të. Qytetarët i shohin ato si platformë legjitime dhe efektive për ngritjen e shqetësimeve dhe avokimin për ndryshim.

1. HYRJE

Pikëpamja tradicionale e politikëbërjes fokusohet në proceset formale ligjore dhe normative. Megjithatë, politikëbërja efektive shtrihet përtej këtyre strukturave. Ajo përfshin të gjitha aspektet e shoqërisë dhe jetës publike, duke siguruar që zërat dhe nevojat e të gjithë qytetarëve të dëgjohen dhe të merren parasysh. Çdo burrë dhe grua, djalë dhe vajzë kosovare duhet të ketë mundësinë që t'i adresojë nevojat, shqetësimet dhe propozimet e tij/saj në mënyrën më adekuate për kapacitetet, nevojat dhe kontekstin e tij/saj. Shoqëria civile ka mundësi, por edhe përgjegjësi, për t'i fuqizuar qytetarët dhe për t'i sjellë shqetësimet dhe zërin e tyre në qendër të vëmendjes së politikave publike dhe diskursit publik.

a. Instrumentet e mbështetjes të EJA Kosovë

Duke njohur diversitetin e shoqërisë civile dhe qasjet e saj të ndryshme, EJA Kosovë fokusohet veçanërisht në nismat dhe individët që përfshijnë në punën e tyre praktikën me pjesëmarrje. Ky fokus bazohet në besimin se shoqëria civile mund t'u përgjigjet vërtet nevojave të qytetarëve vetëm duke i përfshirë ata në mënyrë sistematike dhe të qëllimshme në aktivitetet e saj. Një përfshirje e tillë jo vetëm që rrit ndikimin, transparencën dhe llogaridhënien, por gjithashtu përmirëson praktikën e qeverisjes së brendshme përtej thjeshtë punës me dokumente. Duke u mbështetur në kapacitetet dhe përvojën ekzistuese brenda shoqërisë civile, EJA Kosovë synon ta ngushtojë hendekun ndërmjet shoqërisë civile dhe qytetarëve, duke rritur kështu legjitimitetin dhe ndikimin e saj.

Për t'i mbështetur këto synime, EJA Kosovë ofron disa mekanizma mbështetës: Grante Institucionale, Grante për Zhvillim Organizativ, Grante për Projekte, Grante Urgjente dhe Çmimin Vjetor për Demokraci. Çdo instrument është dizajnuar për të adresuar nevoja specifike brenda shoqërisë civile, duke siguruar që një spektër i gjerë nismash mund të gjejë mbështetjen që u nevojitet.

b. Grantet institucionale

Përveç adresimit të çështjeve specifike me rëndësi për grupe të veçanta të qytetarëve, shoqëria civile mund të kontribuojë në ndryshime më sistematike. Për një kontribut të tillë kërkohet avokim i vazhdueshëm, njohuri të thella mbi çështjen përkatëse dhe sisteme dhe praktika të brendshme të zhvilluara. Këto parakushte nuk plotësohen nëse organizatat operojnë vetëm me financim afatshkurtër ose u kërkohet të zbatojnë aktivitete strikte të projektit, pavarësisht nga konteksti dhe nevojat në ndryshim e sipër. Për ta ruajtur stafin e tyre profesional, organizatat me staf të kualifikuar dhe përvojë solide detyrohen të kërkojnë vazhdimisht mundësi financimi dhe shumë herë të zbatojnë projekte

të shpërndara në shkallë të vogël në vend që të fokusohen në strategjitë e tyre afatgjata. Kjo ndikon në potencialin e tyre për ndryshim dhe rrezikon çdo qëndrueshmëri të ndërhyrjeve të shoqërisë civile.

Duke u bazuar në përvojën e mëparshme të suksesshme të KCSF-së, përfshirë edhe gjatë fazës I të EJA Kosovë, kjo e fundit beson se duke ofruar mbështetje financiare afatgjatë dhe fleksibile, organizatat që kanë demonstruar qëndrueshmëri si agjentë ndryshimi në fushën e tyre të ekspertizës do t'i mbështesin ndërhyrjet e tyre dhe do t'i avancojnë më tej misionet e tyre.

Grantet institucionale synojnë t'i mbështesin planet strategjike të organizatave, duke i ndihmuar ato t'i forcojnë kapacitetet e brendshme organizative dhe të bëhen zëri i qytetarëve në fushat tematike që ato mbulojnë.

Grantet institucionale janë të destinuara për organizatat që janë të konsoliduara, kanë drejtim dhe plan të qartë strategjik dhe kapacitete të dëshmuara teknike dhe organizative. Përfituesit e granteve institucionale pritet të jenë të gatshëm dhe të veprojnë menjëherë në politikat me interes publik që shtrihen në fushën e tyre të veprimtarisë. Ata do të kenë fleksibilitetin e nevojshëm për t'u përshtatur me zhvillimet e jashtme kontekstuale dhe programore dhe do të mobilizohen për të vepruar shpejt kur është e nevojshme. Për më tepër, grantet institucionale u mundësojnë organizatave ta trajtojnë vazhdimisht dhe sistematikisht përfshirjen e qytetarëve në punën e tyre dhe t'i përmirësojnë praktikën e qeverisjes së brendshme. Për më tepër, nëse ata janë përfitues të mëparshëm të Granteve Institucionale nga KCSF-ja, ata pritet të demonstrojnë një trend pozitiv të zhvillimit si në aspektin e kapaciteteve të brendshme ashtu edhe në strategjinë programore, sipas qëllimeve dhe objektivave të mbështetjes së mëparshme institucionale.

2. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E KËRKESAVE TË THIRRJES

a. Kriteret e kualifikueshmërisë

Për t'u kualifikuar për aplikim, organizatat aplikuese duhet t'i plotësojnë kriteret e mëposhtme::

- Të jetë organizatë joqeveritare vendore e regjistruar sipas ligjit në fuqi në Kosovë (degët e OJQ-ve të huaja dhe ndërkombëtare të regjistruara në Kosovë nuk kualifikohen për aplikim);
- Të jetë drejtpërdrejt përgjegjëse për menaxhimin e grantit;
- Të demonstrojë kapacitet për menaxhimin e strategjisë/programit të propozuar;
- Të demonstrojë trend pozitiv të zhvillimit si sa i përket kapaciteteve të brendshme ashtu edhe për strategjinë programore, sipas qëllimeve dhe objektivave të mbështetjes së mëparshme institucionale (për përfituesit e mëparshëm të Granteve Institucionale nga KCSF-ja);
- Nuk drejtohet apo menaxhohet nga Persona të Ekspozuar Politikisht (PEP-të);¹
- Pranon dhe zotohet t'u përmbahet Vlerave Themelore për përfituesit e grantit të EJA²;
- Nuk duhet të mbështetet me grant institucional/themelor nga Sida gjatë periudhës që kërkon mbështetje nga EJA Kosovë.
- Nuk kanë kontratë tjetër aktive në kuadër të EJA Kosovë në kohën kur pritet fillimi i zbatimit të grantit institucional.

b. Organizatat jo - qeveritare

Aplikantët duhet të demonstrojnë se angazhimi i tyre është brenda fushës së demokratizimit dhe fushave të kualifikueshme të programit. Pavarësisht statusit të tyre ligjor, jo të gjitha OJQ-të janë të përfshira në kriteret e mësipërme të kualifikueshmërisë për shkak të fushëveprimit të gjerë të legjislacionit në fuqi për regjistrimin e OJQ-ve në Kosovë. Klubet sportive, federatat sportive, shoqatat kulturore amatore apo organizatat fetare që janë të regjistruara si OJQ nuk kualifikohen për grante të KCSF-së. Ngjashëm, OJQ-të që përfaqësojnë biznese ose subjekte të ngjashme me kapacitet të qartë financiar për t'i mbuluar shpenzimet e organizatës së tyre ose për t'i mbajtur aktivitetet e tyre nuk kualifikohen për grante të KCSF-së.

¹ Për më shumë mbi kufizimet në lidhje me Personat e Ekspozuar Politikisht (PEP-të). Të gjitha organizatat që aplikojnë duhet të deklarojnë se asnjë nga personat në pozitat drejtuese, sipas përkufizimit të Personave të Ekspozuar Politikisht, nuk i përket kësaj kategorie.

² Për më shumë rreth Vlerave themelore për grante të EJA, shih formularin për aplikim. Të gjitha organizatat aplikuese janë të detyruara që t'i pranojnë dhe të përkushtohen që do t'i përmbahen Vlerave themelore për grante të EJA.

c. Numri i aplikimeve

Organizatat mund të dorëzojnë vetëm një aplikacion në këtë Thirrje për Propozime.

d. Afati kohor dhe buxheti

Organizatat mund të aplikojnë për financim për një periudhë minimale 24 muaj dhe maksimum 34 muaj.

Buxheti maksimal i kërkuar për financim nga kjo thirrje nuk duhet të kalojë 40,000 euro/vit (përfshirë auditimin).

Deri në 15% të buxhetit total të propozuar mund të ndahet për zhvillimin organizativ³ (p.sh. sistemet e brendshme, ngritja e kapaciteteve të stafit, pajisjet e zyrës, etj.).

e. Fushat e ndërhyrjes dhe popullsia e synuar

EJA Kosovë fokusohet në kontributin e shoqërisë civile në hartimin e politikave, duke vënë theksin në **integrimin e qytetarëve** në përpjekjet për avokim dhe krijimin e hapësirave dhe praktikave për angazhimin e qytetarëve. Programi synon rritjen e pjesëmarrjes qytetare në proceset e politikave publike në të gjitha nivelet, me fushat me prioritet që përfshijnë pjesëmarrjen e grave dhe grupeve të marginalizuara, përmirësimin e të drejtave socio-ekonomike dhe kulturore, forcimin e rolit mbikëqyrës të shoqërisë civile, fuqizimin e të rinjve në proceset e politikave dhe edukimin qytetar për të drejtat e njeriut. Programi thekson aktivitetet e mbikëqyrës, monitorimin e zbatimit të politikave dhe adresimin e temave të diskutueshme, siç janë çështjet mjedisore dhe përfaqësimi i grupeve të marginalizuara.

EJA Kosovë zotohet t'i mbështesë nismat e fokusuara në adresimin e të **drejtave dhe nevojave të grupeve të marginalizuara**. Këtu përfshihen gratë, personat me aftësi të kufizuara, pakicat etnike: romët, ashkalitë, egjiptianët, serbët, komuniteti LGBTI, të moshuarit dhe të rinjtë.

f. Niveli i ndërhyrjes dhe mbulueshmëria gjeografike

Përmes kësaj thirrjeje do të ofrohet mbështetje për OJQ-të në mbarë Kosovën që synojnë të sjellin transformime në nivel lokal/komunal dhe/ose kombëtar/qendror. Në veçanti, së paku **30 për qind** e përfituesve të granteve institucionale do të jenë organizata të bazuara dhe që operojnë **jashtë Prishtinës**.

³ Kjo thirrje synon të mbështesë kryesisht zbatimin e strategjive ekzistuese të organizatave që aplikojnë, kështu që zhvillimi organizativ nuk është objektivi kryesor i mbështetjes përmes këtij instrumenti. Në fillim të vitit 2026, EJA Kosovë do të lansojë një thirrje specifike të dedikuar vetëm për zhvillimin organizativ të organizatave. Për më shumë shihni seksionin e instrumenteve të EJA Kosovë në këtë link.

g. Angazhimi qytetar

Angazhimi qytetar - EJA Kosovë thekson angazhimin e qytetarëve gjatë gjithë punës së organizatave të mbështetura. Aplikantët për grante institucionale pritët të demonstrojnë qartë se si do t'i **përfshijnë qytetarët** në strategjitë e tyre aktuale dhe punën e ardhshme.

Analiza e target grupit - Aplikantët duhet të paraqesin një analizë të qartë të grupit të tyre të synuar, pse angazhimi dhe pjesëmarrja e tyre është e rëndësishme për punën e organizatës dhe mënyrat e ndryshme që ata synojnë t'i angazhojnë ata.

Në analizën e grupit të tyre të synuar, aplikantët pritët të jenë të vetëdijshëm për **dallimet** brenda grupeve të tyre të synuara (si gjinia, mosha, përkatësia etnike, feja, arsimi, vendndodhja, rrethanat socio-ekonomike, interesat dhe nevojat) dhe t'i përshtatin propozimet dhe ndërhyrjen e tyre në përputhje me rrethanat për t'i adresuar nevojat dhe interesat e ndryshme brenda grupit.

Strategjitë e angazhimit - Nga aplikantët pritët gjithashtu ta analizojnë potencialin e grupeve të synuara për angazhim dhe të shtjellojnë një qasje realiste për **rritjen graduale por sistematike** të përfshirjes së tyre në punën e organizatës.

Për udhëzim mbi angazhimin e qytetarëve, ju lutemi shihni dokumentin e shkurtër **Udhëzues për aplikantët: Angazhimi i qytetarëve** në [faqen e internetit të KCSF-së](#).

Mbështetja e mëparshme nga EJA Kosovë - Nëse aplikantët janë përfitues të mbështetjes së mëparshme nga EJA Kosovë (pavarësisht instrumentit të grantit), ata duhet të ofrojnë një përmbledhje se si i kanë angazhuar qytetarët në punën e tyre deri më tani, duke theksuar progresin dhe sfidat.

OJQ-të e mbështetura do të kenë qasje në mentorim dhe ngritje kapacitetesh mbi avokimin me pjesëmarrje dhe mobilizimin e komunitetit për t'i ndihmuar ata të zhvillojnë një plan për përfshirjen e qytetarëve bazuar në përvojën e tyre të mëparshme.

h. Qeverisja e brendshme

Qeverisja e brendshme e OJQ-ve është një aspekt i rëndësishëm në përpjekjet për të përmirësuar dhe ngritur besimin e qytetarëve në sektorin e shoqërisë civile dhe për të qenë në gjendje të udhëheqin duke qenë shembull për qeverisje të mirë, transparencë dhe llogaridhënie ndaj publikut në përgjithësi. Të gjithë aplikantët duhet të japin informacion mbi mekanizmat e kontrollit të brendshëm, strukturat e menaxhimit dhe qeverisjes, procesin e vendimmarrjes dhe menaxhimin financiar.

Aplikantët e përzgjedhur në listën e ngushtë do t'i nënshtrohen një verifikimi të thellë gjatë vizitave nga KCSF-ja, ku duhet të paraqiten dokumentet mbështetëse për të gjitha kategoritë e lartpërmendura. Nëse aplikantët janë përfitues të mbështetjes së mëparshme nga KCSF-ja në periudhën 2015-2025 (pavarësisht

programit dhe instrumentit të grantit), ata duhet të paraqesin një përmbledhje të aktiviteteve të zhvillimit të brendshëm të mbështetura nga KCSF-ja, gjetjet dhe rekomandimet e auditimit, rekomandimet e monitorimit të KCSF-së, dhe se si secili prej tyre është adresuar nga aplikanti.

Pas vlerësimit fillestar, KCSF-ja do të bëjë punë intensive me organizatat e mbështetura për të zhvilluar mentorim të përshtatur për t'i adresuar praktikën e identifikuar të qeverisjes së mirë, menaxhimin e qëndrueshëm financiar dhe parimet e transparencës, luftën kundër korrupsionit dhe parandalimin e korrupsionit dhe llogaridhënien.

i. Grupet e bashkëpunimit/rrjetëzimit

Pritshmëritë - Për të nxitur bashkëpunim më të madh dhe veprim të përbashkët ndërmjet OJQ-ve, EJA Kosovë do të ofrojë platforma të ndryshme dhe vende takimesh ku OJQ-të mund të takohen, shkëmbejnë dhe ndajnë përvoja mes njëra-tjetrës. Bashkëpunimi për çështje me interes të përbashkët do të ishte një rezultat i synuar, prandaj pritet që organizatat e mbështetura të jenë proaktive në identifikimin dhe kontributin në mobilizimin e nismave të tjera të shoqërisë civile në fushat me interes për to.

Ngjarjet tematike paraqesin një platformë e cila do të jetë në dispozicion të të gjitha organizatave të mbështetura për të propozuar çështje përkatëse në fushëveprimtarinë e tyre dhe/ose çështje që nuk bien drejtpërdrejt në fushëveprimtarinë e tyre, por që konsiderohen të rëndësishme, urgjente dhe relevante. Meqenëse objektivi i EJA Kosovë është të zgjerojë aktivitetin e shoqërisë civile në mbarë vendin dhe të kontribuojë në krijimin e lidhjes me qytetarët, këto ngjarje tematike synohen të organizohen kryesisht jashtë Prishtinës.

j. Çështjet horizontale

Integrimi gjinor, përgjegjësi ndaj mjedisit dhe të drejtat e njeriut do të jenë çështje ndërthurëse dhe horizontale të integruara në të gjitha ndërhyrjet. Integrimi gjinor si një mjet drejt barazisë gjinore kërkon që të gjitha organizatat e mbështetura të sigurojnë që ndërhyrjet e tyre të marrin parasysh në mënyrë të barabartë efektet te burrat dhe gratë, djemtë dhe vajzat dhe të shmangin kontributin në stereotipe të dëmshme. Konsideratat mjedisore kërkojnë që të gjitha ndërhyrjet të kenë parasysh ndikimin e tyre në mjedis, duke promovuar qëndrueshmërinë dhe duke minimizuar efektet negative në mjedis. Parimet e të drejtave të njeriut do t'i udhëheqin të gjitha aktivitetet për të siguruar që në ato aktivitete respektohen, mbrohen dhe promovohen të drejtat dhe dinjiteti i të gjithë individëve të përfshirë, duke shmangur çdo formë diskriminimi ose padrejtësie.

3. KUALIFIKUESHMËRIA E AKTIVITETEVE DHE SHPENZIMEVE

a. Ndërhyrjet/aktivitetet jo të kualifikueshme

Aktivitetet e mëposhtme nuk do të mbështeten:

- Ndërhyrjet që janë të lidhura drejtpërdrejt me ose janë mbështetëse të partive politike ose kandidatëve për zgjedhje politike;
- Ndërhyrjet që janë në kundërshtim me vlerat themelore për përfituesit e granteve të EJA;
- Investimet kapitale;
- Grantet e përbëra tërësisht ose kryesisht nga punë përgatitore dhe/ose studime;
- Projektet dhe aktivitetet ndërkufitare;
- Aktivitetet që do të zbatohen jashtë Kosovës (përveç takimeve me organizatat partnere ose rrjetet me qëllim të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave);
- Aktivitetet e llojit të shërbimit, si ato të ngjashme me Asistencën Teknike;
- Fushata ndërgjegjësuere pa veprime të duhura pasuese;
- Ndërhyrjet që varen nga miratimi në shumë nivele nga palët e treta dhe që paraqesin rrezik joproporcional të lartë për dështim dhe mosarritjeje rezultatesh;
- Nëngrante për palët e treta. Mbështetja financiare në shkallë të vogël për përfituesit e punës së organizatës lejohet vetëm në rastet kur të gjitha shpenzimet kryhen nga organizata zbatuese;
- Bursat.

Përveç nëse ato janë të domosdoshme për arritjen e objektivave të synuara të strategjisë organizative, në parim, aktivitetet e përshkruara më poshtë nuk do të mbështeten:

- Konferenca, diskutime në tryeza të rrumbullakëta ose ngjarje të tjera të ngjashme në vende (si hotele) që nuk janë të hapura dhe lehtësisht të qasshme për qytetarët e zakonshëm;
- Hulumtim dhe studime të fizibilitetit, veçanërisht si një mjet për të hartuar pjesën tjetër të ndërhyrjes;
- Udhëtime studimore jashtë Kosovës.

b. Kostot e kualifikueshme

Për t'u konsideruar të kualifikueshme, kostot duhet t'i plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- të jenë të nevojshme për zbatimin dhe arritjen me sukses të rezultateve të treguara të ndërhyrjes;
- të jenë të arsyeshme, të justifikuara dhe në përputhje me kërkesat e menaxhimit të shëndoshë financiar, duke përfshirë llogaritjet e drejta dhe të bazuara në treg dhe efikasitetin e kostos;
- t'i përmbushin kërkesat e legjislacionit tatimor në fuqi në Kosovë;
- të ndodhin gjatë zbatimit të grantit;
- të tregohen në buxhetin e miratuar;
- të jenë të identifikueshme dhe të gjurmueshme.

c. Kostot jo të kualifikueshme

Kostot e paraqitura më poshtë konsiderohen jo të kualifikueshme:

- Detyrimet doganore dhe të importit;
- Borxhi ose pagesa për humbje;
- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar - TVSH (për të gjitha faturat mbi 200 euro);
- Ripagesat e huasë dhe interesit;
- Tarifat e këmbimit valutor;
- Shpenzimet e amortizimit të pajisjeve;
- Blerja e tokës ose e pronës së paluajtshme;
- Blerja e automjetit ose gjeneratorit;
- Pagesa e shpenzimeve të mbuluara nga donatorë të tjerë;
- Kredi për palët e treta.

4. PROCEDURA E APLIKIMIT

a. Dorëzimi i aplikacioneve

Të gjitha aplikacionet për grante të EJA Kosovë duhet të dorëzohen përmes platformës online.

Aplikantët duhet t'i japin informatat e tyre, ta shtjellojnë idenë dhe t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme përmes [sistemit të aplikimit online](#).

Për udhëzime mbi regjistrimin dhe përdorimin e sistemit online të aplikimit, ju lutemi referojuni informacionit në dispozicion në [faqen e internetit](#) të sistemit online të aplikimit.

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me regjistrimin ose aplikimin për grant, ju lutemi na dërgoni me e-mail në ēja@kcsfoundation.org. Të gjitha pyetjet dhe përgjigjet në lidhje me aplikacionin do të publikohen në seksionin pyetje dhe përgjigje të faqes së internetit të KCSF-së. Aplikantët këshillohen ta kontrollojnë rregullisht këtë seksion.

b. Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është data **26/10/2025, në orën 23:59**.

Pas këtij orari, sistemi online do të mbyllet automatikisht dhe aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

Ne i inkurajojmë fuqimisht aplikantët t'i dorëzojnë aplikacionet e tyre shumë përpara afatit për ta shmangur çdo vështirësi teknike të minutës së fundit për shkak të trafikut të madh të internetit ose ndonjë defekti me lidhjen e internetit (përfshirë dështimin e energjisë elektrike, etj.), ose trafikun e madh të internetit në sistemin online të aplikimit që mund të çojë në vështirësi në dorëzim. KCSF-ja nuk mund të mbajë përgjegjësi për ndonjë vonesë për shkak të vështirësive të lartpërmendura.

c. Kontakti

Për pyetje në lidhje me procesin e aplikimit mund të na kontaktoni në ēja@kcsfoundation.org jo më vonë se **17/10/2025**. Të gjitha pyetjet dhe përgjigjet do të publikohen në seksionin pyetje dhe përgjigje të faqes së internetit të KCSF-së jo më vonë se **22/10/2025**.

Ju lutemi përdoreni vetëm këtë e-mail për komunikim me KCSF-në lidhur me procesin e aplikimit.

DOKUMENTET E DETYRUESHME

Përveç formularit të aplikimit për grant institucional, aplikantët duhet t'i dorëzojnë/ nënshkruajnë në platformën online dokumentet e mëposhtme:

- 1 Certifikata e Regjistrimit të OJQ-së e lëshuar nga Departamenti i OJQ-ve;
- 2 Deklarata për Personat e Ekspozuar Politikisht (PEP) (nënshkruhet sipas shabllonit të EJA Kosovë në pjesën e fundit të formularit të aplikimit në sistemin online të aplikimit);
- 3 Deklarata mbi vlerat themelore për përfituesit e grantit të EJA (nënshkruhet sipas shabllonit të EJA Kosovë në pjesën e fundit të formularit të aplikimit në sistemin online të aplikimit);
- 4 Dokumenti Strategjik i Organizatës (i cili mbulon të gjithë ose pjesën më të madhe të periudhës së grantit);
- 5 Buxheti i të gjithë organizatës për periudhën e aplikimit, me ndarje të qartë të atyre linjave buxhetore për të cilat kërkohet mbështetje nga EJA Kosovë, si dhe specifikimi dhe arsyetimi i pagave (sipas shabllonit të EJA Kosovë, i qasshëm në sistemin online të aplikimit);
- 6 Plani vjetor i punës i të gjithë organizatës për periudhën e aplikimit, ndarja e qartë e aktiviteteve kryesore për të cilat kërkohet mbështetje nga EJA Kosovë (sipas shabllonit të EJA Kosovë i qasshëm në sistemin online të aplikimit);
- 7 Korniza Logjike e Dokumentit Strategjik të Organizatës (sipas shabllonit të EJA Kosovë i qasshëm në sistemin online të aplikimit).

DOKUMENTET E DETYRUESHME PAS PËRZGJEDHJES NË LISTËN E NGUSHTË⁴

- 1 Statuti i organizatës (versioni i nënshkruar identik me Statutin siç është dorëzuar në Departamentin e OJQ-ve);
- 2 Në rast se aplikanti është fondacion ose institut, lista e anëtarëve të Bordit Drejtues;
- 3 Në rast se aplikanti është shoqatë, emri i Kryetarit të Kuvendit të Anëtarëve dhe lista e anëtarëve të Kuvendit të organizatës. Gjithashtu, nëse shoqata ka bord ndërmjetësues apo organe të tjera, listën e anëtarëve të këtij organi;
- 4 Pasqyrat financiare vjetore të organizatës⁵ për dy (2) vitet e fundit (2023 dhe 2024)
- 5 Raportet e auditorit për dy (2) vitet e fundit (2023 dhe 2024), nëse organizata që aplikon obligohet me ligj të posedojë raport auditimi, ose nëse organizata e ka atë pavarësisht detyrimeve ligjore).

⁴ Të gjitha shtojcat e detyrueshme duhet të paraqiten veçmas si dokumente të veçanta dhe të renditura nga 1 deri në 5.

⁵ Pasqyrat financiare vjetore duhet në minimum të tregojnë bilancin dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Raportet e auditimit duhet të mbulojnë dy pasqyra financiare të organizatës. Për organizatat e krijuara së fundmi, vetëm nëse është e aplikueshme.

5. VLERËSIMI DHE NJOFTIMI

Vlerësimi i aplikimeve për Grant Institucional do të bëhet në dy faza:

- 1) Kontrolli administrativ (verifikimi i kriterëve formale dhe i të gjithë dokumentacionit të kërkuar siç specifikohet në udhëzimet për aplikime) dhe
- 2) Vlerësimi i përmbajtjes (bazuar në kategoritë dhe kriteret e vlerësimit).

a. Kontrolli administrativ

Gjatë kësaj faze të gjitha aplikacionet vlerësohen nëse pikat e mëposhtme kanë qenë në përputhje me thirrjen:

- 1 Të gjitha kërkesat administrative dhe teknike.
- 2 Kriteret e kualifikueshmërisë për organizatat.
- 3 Dokumentet e detyrueshme.
- 4 Shuma e kërkuar, dhe
- 5 Kohëzgjatja e grantit.

Aplikacionet që nuk plotësojnë kriteret e specifikuara nuk do të kalojnë në fazën e vlerësimit të përmbajtjes.

Rezultatet e pajtueshmërisë administrative do t'i komunikohen çdo aplikanti me shkrim.

b. Vlerësimi i përmbajtjes dhe vendimi përfundimtar

Aplikacionet që kalojnë kontrollin administrativ do të vlerësohen nga Ekipi i Vlerësimit të Granteve (EVG) i përbërë nga pesë ekspertë të jashtëm me ekspertizë dhe njohuri përkatëse.

Ekipi i Vlerësimit të Granteve do t'i vlerësojë aplikacionet bazuar në kriteret dhe peshën e mëposhtme:

- 1 Cilësia e strategjisë së organizatës (30%)
- 2 Përfshirja e qytetarëve/grupeve të synuara në punën e organizatës (30%)
- 3 Çështjet /horizontale (10%)
- 4 Niveli i kapacitetit organizativ (10%)
- 5 Rëndësia e përvojës së mëparshme (10%)
- 6 Efektiviteti i kostos së buxhetit të propozuar (10%)

Vlerësimi maksimal për aplikim është 100 pikë.

Vlerësimi i propozimeve nga EVG do të bëhet në dy faza:

- 1) Shqyrtimi i dokumenteve të dorëzuara, dhe
- 2) Intervistat publike.

Pas vlerësimit fillestar të aplikacionit të dorëzuar dhe të gjitha dokumenteve të tjera të detyrueshme, në listën e ngushtë hyjnë aplikantët që kanë marrë të paktën **65 pikë** (nga 100), si dhe **gjysmën e pikëve në dispozicion** (50%) në secilën nga gjashtë kategoritë e paraqitura më sipër.

KCSF-ja do të organizojë vizita në terren për të gjithë aplikantët e përzgjedhur në listën e ngushtë. Përpara vizitës në zyrë, aplikantëve të përzgjedhur në listën e ngushtë mund të ju kërkohet të dorëzojnë dokumente dhe informata shtesë në lidhje me qeverisjen e brendshme.

Vizita e stafit të KCSF-së do të fokusohet në qeverisjen e brendshme dhe menaxhimin financiar, si dhe konfirmimin se janë adresuar rekomandimet për përfituesit e mëparshëm të granteve të KCSF-së. Pas vizitës dhe çdo konfirmimi shtesë vijues, KCSF-ja përgatit një raport për secilën organizatë në listën e ngushtë, me kategoritë e mëposhtme të vlerësimeve:

- Shumë mirë: Të gjitha ose pothuajse të gjitha elementet vlerësohen si të përshtatshme për madhësinë dhe natyrën e punës dhe organizimit (ose natyrën e rekomandimeve), pa çështje të rëndësishme për t'u adresuar dhe me rrezik të ulët dështimi nëse jepet granti.
- Mjaftueshëm: Shumica e elementeve vlerësohen si të përshtatshme për madhësinë dhe natyrën e punës dhe organizimit (ose natyrën e rekomandimeve). Megjithatë, ka disa elemente të rëndësishme për t'u adresuar gjatë zbatimit për ta ulur rrezikun e dështimit nëse jepet granti.
- I pamjaftueshëm: Një pjesë e konsiderueshme e elementeve vlerësohen si të papërshtatshme për madhësinë dhe natyrën e punës dhe organizimit (ose natyrën e rekomandimeve), me rrezik shumë të lartë dështimi nëse jepet granti, duke e bërë të papranueshme dhënien e grantit.

Organizatave në listën e ngushtë të vlerësuara se kanë një nivel të pamjaftueshëm të qeverisjes së brendshme, menaxhimit financiar dhe adresimit të rekomandimeve të mëparshme nuk do të ftohen për intervista publike.

Intervista publike do të përbëhet nga një prezantim i shkurtër i propozimit të grantit (10 minuta) i pasuar nga një sesion pyetjesh dhe përgjigjesh (10 minuta) me anëtarët e EVG-së.

Pas përfundimit të intervistave, EVG-ja do të rekomandojë listën e aplikantëve që duhet të financohen. Për t'u kualifikuar për financim, aplikantët duhet të arrijnë një minimum prej 75 pikësh në përgjithësi, si dhe të paktën 50% të pikëve në dispozicion në secilën nga gjashtë kategoritë e vlerësimit.

Përzgjedhja përfundimtare e aplikantëve të rekomanduar për financim do të varet nga disponueshmëria e fondeve dhe duhet të plotësojnë kuotën gjeografike, ku së paku 30% e përfituesve janë organizata me bazë dhe që operojnë jashtë Prishtinës.

Donatorët kanë të drejtën e vetos për çdo aplikant në listën e rekomanduar nëse konsiderohet se bien ndesh me vlerat e promovuara nga donatori ose nëse mbivendosen me ndërhyrje të tjera të ngjashme të financuara nga donatori përkatës. Vetoja e donatorëve është përfundimtare dhe aplikantët nuk mund ta apelojnë vendimin.

KCSF-ja do t'i mbështesë aplikantët e suksesshëm për ta finalizuar dosjen gjatë fazës së përgatitjes së kontratës dhe fazës fillestare. Gjatë kësaj faze, duhet të plotësohen të gjitha kushtet e vendosura nga EVG-ja. KCSF-ja gjithashtu rezervon të drejtën të sugjerojë rregullime të vogla që nuk ndryshojnë aspektet themelore të aplikacionit ose aktivitetet e miratuara, por mund të përmirësojnë zbatimin me sukses të grantit institucional.

c. Njoftimi për vendimin dhe mekanizmi ankimor

Vendimet për financim të marra nga Ekipi për Vlerësimin e Granteve dhe që nuk vihen veto nga donatorët janë përfundimtare. Pas përfundimit të këtij procesi, KCSF-ja do t'i informojë aplikantët e pasuksesshëm me rezultatet e aplikimit të tyre, duke përfshirë pikët totale, pikët për kategori dhe renditjen përfundimtare. Informata të mëtejshme mund të ofrohen nga KCSF-ja vetëm me kërkesë, në formën e një përmbledhjeje të komenteve anonime nga anëtarët e Ekipit për Vlerësimin e Granteve.

Ankesa formale mund të paraqitet vetëm në rastet kur aplikantët e pasuksesshëm kanë arsye të forta për të besuar se një dokument specifik i dorëzuar nga ata është lënë jashtë procesit të vlerësimit, duke rezultuar në rezultate dukshëm më të ulëta në një kategori të caktuar ose në përgjithësi. Ankesa formale do të dorëzohet në bazë të shabllonit zyrtar të ankesës të publikuar në ueb faqen e KCSF-së **brenda dy ditëve** të punës pas njoftimit nga KCSF.

Drejtori Ekzekutiv i KCSF-së do të themelojë një komision të brendshëm për të vlerësuar nëse lëshimi i pretenduar ka ndodhur realisht, bazuar në dëshmitë e dorëzuara nga aplikanti i pasuksesshëm dhe në informatat që mund të gjurmohen nga sistemi i vlerësimit i KCSF-së. Në rast se komisioni i brendshëm konfirmon se lëshimi ka ndodhur realisht, dokumenti i hequr do të përfshihet në dosje dhe aplikacioni do të rivlerësohet nga EVG-ja dhe rezultati i ri që rezulton nga rivlerësimi do të përfshihet në renditjen përfundimtare të aplikantëve.

ROLI I KCSF-së

EJA Kosovë është program i KCSF-së që aktualisht financohet bashkërisht nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Suedia. KCSF-ja është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e programit, në bashkëpunim të ngushtë me donatorët financues për çështjet strategjike dhe kryesore operacionale.

Vlerësimi i aplikacioneve individuale kryhet nga Ekipi për Vlerësimin e Granteve i përbërë nga vlerësues të jashtëm, ku KCSF-ja ka rol mbështetës që përfshin elementet e mëposhtme: përcaktimi i kriterëve të vlerësimit, dizajnimi i sistemit të vlerësimit, përzgjedhja e rastësishme e anëtarëve të EVG-së nga grupi i vlerësuesve të jashtëm të kontraktuar nga KCSF-ja, realizimi i kontrollit administrativ të aplikacioneve të dorëzuara, duke organizuar vizita në terren tek aplikantët e përzgjedhur për verifikimin e dokumenteve dhe praktikave të qeverisjes së brendshme, duke vlerësuar nivelin e qeverisjes së brendshme bazuar në dokumentet e dorëzuara dhe rezultatet e vizitave në terren, vlerësimi i nivelit të përcjelljes dhe përmbytjes së kërkesave formale nga grantet e mëparshme me KCSF-në dhe/ose rekomandimet e auditimit, si dhe udhëzimet metodologjike për dhe monitorimin e anëtarëve të EVG-së për zbatimin adekuat të sistemit dhe metodologjisë së vlerësimit.

Pas vendimeve përfundimtare për financimin të marra nga Ekipi për Vlerësimin e Granteve dhe përfundimit të procesit të vetos nga donatorët, KCSF-ja ndërmerr hapat e mëposhtëm: përgatit kontratën e grantit, mbështet përfituesin e grantit në finalizimin e dokumenteve të zbatimit (buxheti final, korniza logjike, plani i aktiviteteve) dhe planit për ngritjen e kapaciteteve dhe rrjetëzimin, monitoron rregullisht zbatimin e grantit, merr dhe miraton raporte periodike nga përfituesit e grantit bazuar në udhëzimet dhe modelet e raportimit, kontraktin kompanitë audituese për të kryer auditime të jashtme të grantit, organizon dhe/ose lehtëson aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve dhe rrjetëzimin për përfituesit e granteve dhe komunikon me përfituesit e granteve për çështje të ndryshme që lidhen me zbatimin me sukses të grantit.

7. DATA TË RËNDËSISHME TENTATIVE

Procesi	Data tentative
Lansimi i thirrjes për Grante Institucionale	25/09/2025
Sesion informativ (online):	Detajet në www.kcsfoundation.org dhe Faqja e KCSF-së në FB
Afati i fundit për pyetje dhe sqarime	17/10/2025
Data e fundit për t'i publikuar përgjigjet	22/10/2025
Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve	26/10/2025
Informata mbi rezultatin e kontrollit administrativ	03/11/2025
Informata mbi aplikantët e përzgjedhur në listën e ngushtë	Dhjetor
Vizita nga KCSF-ja tek aplikantët e përzgjedhur në listën e ngushtë	Dhjetor/janar
Intervistat publike	Dhjetor/janar
Vendimi përfundimtar	Janar/shkurt 2026
Nënshkrimi i kontratave	Shkurt 2026
Fillimi i zbatimit të granteve	Mars 2026